



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:147475

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05420841

KF.nr.323/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me Gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në çështjen juridike të paditësit D.R. nga Ferizaj të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat L.M., kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, jashtë seancës, me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë/Departamenti Fiskal SHPALLET JO KOMPETENT në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditësit D.R. nga Ferizaj.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, lënda së bashku me shkresat e saj, i dërgohet Departamenti për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësi, D.R. nga Ferizaj, përmes të autorizuarit të tij, me datën 05.07.2023 ka ushtruar padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit nr. 87/23, të datës 12.05.2023.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së si dhe nenet 11, par 2 dhe 13 të ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, shqyrtoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe vlerësoi se Dhomat e Shkallës së Parë/Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale, nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë lëndë.

Për të vlerësuar kompetencën, Gjykata fillimisht iu referua Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, e i cili ligj në nenin 11, paragrafi 2, shprehimisht përcakton se “Dhomat e Shkallës

*së Parë janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet në juridiksionin e Gjykatës Komerciale”, dhe nenit 13, par 4 ku taksativisht thuhet se “Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal“*

Gjykata i'u referua edhe nenit 13, par 1, nën par 1.11, të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, e ku është përcaktuar qartë se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore.

Lidhur me këtë Gjykata konstatoi se pala paditëse është person fizik, pra nuk e ka statusin e ndonjë nga shoqërive tregtare siç përcaktohet me Ligjin nr. Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, dhe si rrjedhojë në kuptim të dispozitave së lartcekur, kontest-tregtar administrativ, pranë Departamentit Fiskal të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, nuk mund të zhvillohet.

Prandaj, Dhomat e Shkallës së Parë/ Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale, duke u bazuar në nenet 19, dhe 23, par 1, të LPK-së, si dhe neneve 11, par 2, 13, par 1, nën par 1.11, dhe par 2 të këtij neni të Ligjit mbi Gjykatën Komerciale 08/L-015, konstatoi qe kjo çështje juridike nuk bie ne kompetencën lëndore të këtij Departamenti, andaj komfor Nenit 387.1 pika (u) dhe Nenit 392 pika (b) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.323/23, datë 07.03.2024

G j y q t a r i

Fisnik NULI

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.